



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË



Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • **Tel:** ++355 4 222230; 222750; 235568
• **Fax:** ++355 4 223558 • **Website** www.bankofalbania.org • **E-mail:** public@bankofalbania.org

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR TREMUJORIN E DYTË TË VITIT 2004

Ekspansioni i shkëmbimeve në aktivitetin tregtar, deficiti i lartë i llogarisë korente, rritja e njëkohshme e detyrimeve dhe mjeteve financiare ndaj botës e shoqëruar me rritjen e rezervave të autoritetit monetar, përshkruajnë në vija të përgjithshme zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë për tremujorin e dytë të vitit 2004.

Deficiti korent në fund të tremujorit, i vlerësuar rreth 134 milionë dollarë, shkaktuar nga bilanci negativ i kursim-investimeve të qeverisë, tregon se Shqipëria vazhdon të financohet nga kursimet e pjesës tjetër të botës. Ky deficit përfaqëson 6.6 për qind të PBB-së nga 7.6 për qind që ishte në vitin 2003.

Importet e larta të kapitaleve, kryesisht në formën e investimeve të huaja direkte dhe të huamarrjes, kanë mbuluar tërësisht deficitin korent dhe kanë çuar në rritjen e rezervave valutore.

Vëllimi i përgjithshëm tregtar gjatë periudhës u vlerësua në 680 milionë usd ose rreth 93 milionë usd më i lartë se ai i të njëjtës periudhë për vitin 2003. Importet e kësaj periudhe, duke shënuar 527 milionë usd, i tejkaluan ato të tremujorit të dytë të vitit të kaluar me rreth 16 për qind, ndërkohë që eksportet, pavarësisht nga rritja prej 35 për qind, nuk arritën të ngushtonin deficitin tregtar. Ky i fundit, për tremujorin dytë të vitit, vlerësohet në 374 milionë usd. Aktiviteti tregtar ka qenë më i vrullshëm gjatë tremujorit të dytë, sidomos në krahun e importeve, dukuri që është vërejtur edhe gjatë viteve të kaluara.

Mbetet e lartë kërkesa për importe në mallra për konsum dhe investime. Efektin më të madh në rritjen e importeve kundrejt tremujorit të dytë të vitit të kaluar e dhanë importet në makineri dhe pajisje në mjete transporti si edhe importet në produkte vegjetale.

Rritja e eksportit këtë tremujor ka ardhur kryesisht nga rritja në rieksperte (industri e veshjeve tekstile dhe e atyre të këmbëve), të cilat kryesojnë të ardhurat nga eksporti i mallrave në rreth 75 për qind të vëllimit të përgjithshëm. Gjithashtu, në ecuri pozitive paraqitet eksporti nga prodhimi i brendshëm. Të ardhurat nga eksportet në këtë kategori vlerësohen rreth 67 për qind më të larta krahasuar të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, gjë që erdhi kryesisht nga rritja e eksporteve në metale (ferrokrom) si dhe në produkte minerale.

Pas deficiteve të njëpasnjëshme, të regjistruara që nga tremujori i dytë i vitit 2003, bilanci i shërbimeve këtë tremujor iu kthye përsëri shifrave pozitive (0.1 milionë dollarë). Ky suficit erdhi si pasojë e rritjes së eksporteve të shërbimeve kryesisht si pasojë e rritjes së madhe të të ardhurave nga aktiviteti i turizmit dhe i shërbimeve të komunikacionit.

Eksporti i shërbimeve është rreth 1.6 herë më i lartë se ai i mallrave dhe kjo është mundësuar kryesisht prej shërbimeve të turizmit. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë ky aktivitet ka gjeneruar të ardhura rreth 167 milionë dollarë, shifër kjo rreth 9 për qind më e lartë se eksporti i mallrave. Mund të thuhet se gjatë këtij tremujori ka pasur një rritje të madhe në numrin e udhëtarëve që kanë hyrë në Shqipëri, me rreth 35 për qind, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar dhe ky mund të konsiderohet si një tregues i mjaftueshëm që dëshmon për rritjen e aktivitetit në këto shërbime. Ky fakt evidenton edhe një herë avantazhin konkurrues të Shqipërisë në tregtinë e shërbimeve të turizmit.

Ndërkohë, shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 141 milionë dollarë amerikanë ose rreth 70 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët. Në shpenzimet për importin e shërbimeve, një peshë të konsiderueshme zënë edhe shërbimet e transportit, si pasojë e rritjes së importit dhe ato të komunikacionit të cilat zënë respektivisht 20 dhe 18 për qind.

Bilanci pozitiv i të ardhurave, në fund të tremujorit, vlerësohet rreth 124 milionë dollarë. Ky suficit i dedikohet të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë dhe atyre kufitarë, dhe interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente si dhe atyre të përfuara nga investimet e sistemit tonë bankar në formën e investimeve të portofolit. Megjithë rritjen e të ardhurave nga investimet e portofolit prej 22 milionë, krahasuar me periudhën paraardhëse ashtu edhe me atë të një viti më parë ky suficit vlerësohet në rënie, respektivisht me 11 dhe 24 për qind. Rënia e këtij suficiti ka të bëjë me rënien e të ardhurave nga investimet në formën e depozitave të sistemit bankar jashtë, si dhe me rritjen e të ardhurave dalëse në formën e shlyerjes së borxhit të jashtëm (pagesave të interesave të maturuar), të cilat regjistruan shifrën 6.6 milionë dollarë.

Transfertat nga emigrantët kanë regjistruar shifrën 201 milionë dollarë. Sipas statistikave, vlerësohet që rreth 50 për qind e këtyre hyrjeve në mjete valutore ka hyrë në sistemin bankar dhe institucionet financiare në formën e transfertave përmes tyre, pjesa tjetër ka hyrë në formën cash duke nxitur kryesisht rritjen e importeve të mallrave të konsumit. Këto flukse kanë financuar me rreth 54 për qind deficitin tregtar. Këto burime luajnë një rol kryesor në financimin pjesërisht të deficiteve të larta tregtare dhe regjistrojnë një rritje prej 16 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Ndërkohë, transfertat shtetërore regjistrojnë 16.5 milionë dollarë dhe përfaqësohen nga ato në asistencë teknike dhe ato në formë ndihmash në mallra. Duke përfshirë edhe transfertat neto private, bilanci pozitiv i transfertave korente, në fund të tremujorit u vlerësua rreth 208 milionë dollarë.

Flukset neto të kapitalit regjistruan 207.6 milionë dollarë duke mundësuar kështu plotësisht financimin e deficitit korent si dhe rritjen e rezervave valutore të autoritetit montetar, me rreth 117 milionë dollarë. Këto flukse janë në formën e transfertave kapitale, të cilat vlerësohen me 25.7 milionë dollarë dhe flukset neto të kapitaleve në formën e investimeve me rreth 182 milionë dollarë.

Flukset hyrëse të kapitaleve të cilat vlerësohen rreth 202.6 milionë dollarë (ose 2.4 herë më të larta se tremujori i dytë i vitit 2003) reflektojnë rritjen e detyrimeve financiare të ekonomisë shqiptare me botën. Burimi kryesor i rritjes së këtyre detyrimeve janë investimet e huaja direkte në formën e privatizimit të sistemit bankar si dhe në formën e investimeve të tjera.

Kapitaleve në formën e investimeve të huaja direkte i janë shtuar edhe lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, duke rritur borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 52.6 milionë dollarë, nga të cilat huamarrja shtetërore zë 43 për qind.

Detyrimet në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar kanë rënë me 18.6 milionë dollarë. Këto depozita janë kryesisht në euro dhe në dollarë respektivisht rreth 75 dhe 21 për qind të tyre.

Mjetet financiare të Shqipërisë në pjesën tjetër të botës, janë rritur me 20.7 milionë dollarë. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e investimeve direkte të sistemit bankar jashtë me rreth 11 milionë dollarë dhe të mjeteve të tjera financiare me 10.4 milionë dollarë, ndërkohë që investimet e portofolit kanë rënë më 4 milionë dollarë.

Flukset hyrëse në mjete valutore, në formën e investimeve të huaja direkte nga privatizimi u reflektuan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar me rreth 117.4 milionë dollarë. Niveli rezervave valutore, në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2004, u vlerësua në rreth 1.1 miliardë dollarë, i mjaftueshëm për të përballuar 4.8 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Bilanci i Pagesave (në milionë dollarë amerikanë)

	3m-II 2003	3m-I 2004	3m-II 2004
Llogaria korente	-120.56	-74.59	-133.85
Eksporti i mallrave	113.72	136.45	153.17
Importi i mallrave	-453.80	-451.28	-527.26
Bilanci tregtar	-340.08	-314.83	-374.09
Shërbimet: Kredi	179.13	196.65	238.12
Shërbimet: Debi	-194.35	-202.61	-238.07
Të ardhurat: Kredi	49.17	41.60	40.39
Të ardhurat: Debi	-6.86	-5.25	-8.23
Transferta private pashpërblim	176.98	196.84	191.57
Transferta shtetërore pashpërblim	15.44	13.02	16.47
Llogaria kapitale	36.46	34.04	25.72
Llogaria financiare	56.04	19.15	181.90
Investime direkte	48.26	35.00	176.70
Investime portofoli	5.45	-1.30	4.00
Kapitale të tjera*	2.33	-14.56	1.20
Gabime dhe harresa neto	32.28	30.30	43.63
Bilanci i përgjithshëm	4.21	14.88	117.41
Rezervat dhe zëra të Lidhur me to.			
Mjetet e rezervës	-4.21	-14.88	-117.41
Përdorim huash e kredish nga FMN	0.00	5.99	0.00
Për t'u mbajtur në vëmendje			
Ndryshimi total në rezerva	-24.41	-2.58	-113.86
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	20.20	-12.30	-3.55

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.
Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

Tiranë, më 04.11.2004